

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit N. M. , nga fshati L. – H., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.257-6/2016 të datës 29.02.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Fatos Ajvazi, dhe të akuzuarit, me date 01.02.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N. M., nga i ati H. dhe nëna S. e lindur M., i lindur me datën *data e lindjes...* në fshatin L. – H., Komuna e P., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, furrhtar, i martuar, baba i pesë fëmijëve, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 08.10.2015, në Prizren, pikërisht në shtëpinë e tij, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njehsor me nr. 21060109, i cili në brendi për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmik është penguar puna e diskut ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS, Departamentit ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material,

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës .

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51 par.4, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, të akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe

Dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat të verifikimit prej 1 (një) viti i akuzuari nuk kryen vepër të re penale,

E dëmtuara: KEDS, Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.257-6/2016 të datës 29.02.2016 kundër të akuzuarit N. M., nga fshati L. – H., Komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës

Prokurori i shtetit Fatos Ajvazi, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.257-6/2016 të datës 29.02.2016, kundër të akuzuarit N. M., nga fshati L. – H., Komuna e P., për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së , dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari N. M., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, ne jetojmë në bashkësi familjare, andaj nga këto rrethanat për shkak të kushteve jam detyruar që të punoj për mbajtjen e ekzistencës së familjes sime dhe përkohësisht jam duke ushtruar veprimtarin e bukë pjekësit në shtetin e Maqedonisë, shtëpia ime familjare gjendet në fshatin L. – H., Komuna e P., andaj sa i përket kësaj vepre penale e pranoj të njëjtën me vetë faktin që me rastin e kontrollimit të njehsorit nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, është vërtetuar që e njëjta ka pasur ndërhyrje të pa autorizuar, kush dhe kur e ka bërë këtë ndërhyrje, unë nuk e di, por pranimin e fajësisë e bëj për arsye që njehsori është në emrin tim, andaj nga të cekurat i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, rrethanat e mija personale, që jam person familjar, baba i pesë fëmijëve, dhe kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, e po ashtu gjykatës i parashtroj edhe certifikatën e veteranit luftëtar të UÇK-ës, me numër të protokollit L5/6568 të datës 26.01.2016, andaj konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të gjitha rrethanat të cekura më lart gjykata ti merr si rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 08.10.2015, në Prizren, i akuzuari pikërisht në shtëpinë e tij, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njehsor me nr. 21060109, i cili në brendi për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmik është penguar puna e diskut ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS, Departamentit ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe

pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës .

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtë, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i pesë fëmijëve, është veteran i luftës të UÇK-ës, sipas certifikatës me numër të protokollit L5/6568 të datës 26.01.2016, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat të verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat të verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.456/2016 me datë 01.02.2017

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.